



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 6060 Prot.

Tiranë, më 20. 7. 2026

URDHËR

Nr. 304, Datë 20. 7. 2026

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E TERMAVE TË
REFERENCËS (TOR) PËR REKRUTIMIN EKSPERT/E I/E MENAXHIMIT TË
PROJEKTIT DIGITAL INNOVATION UNIT (DIU)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit 90 datë 27.09.2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore, “Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Bashkimit Europa Digjitale (2021-2027), ratifikuar me ligjin nr. 87/2023, Marrëveshjes së Grantit “Digital Innovation Unit” nr. 101191700-DIU:

URDHËROJ

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Termave të Referencës për rekrutimin për pozicionin “Ekspert/e i/e Menaxhimit të Projektit Digital Innovation Unit”, hartimin e përshkrimeve të punës dhe kërkesave për kualifikim (kriteri teknik dhe financiar) për pozicionin, me përbërjen si më poshtë:

- Z. Bledar Taushani (Kryetar)
- Znj. Albjona Ocelli (Anëtar)
- Znj. Gerzheta Akshia (Anëtar)

2. Afati i përgatitjes së Termave të Referencës është brenda 7 ditëve kalendarike nga dalja e këtij urdhri.

3. Grupi i punës të mbajë procesverbalin e miratimit të kërkesave si më lart dhe do të asistohet nga Z. Mateo Agolli në cilësinë e sekretarit.

4. Termat e Referencës së bashku me një kopje të proces-verbalit pas miratimit nga ana e Titullarit të institucionit, të dorëzohet në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për Çështjet e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit, për kryerjen e procedurave të mëtejshme.

5. Ngarkohet Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për çështjet e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit në bashkëpunim me drejtorinë e IT në MEI për njoftimin për shpalljen e pozicioneve të punës në faqen zyrtare të MEI dhe në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit për një periudhë prej 7 ditësh kalendarike.

6. Të ngrihet grupi i punës për rekrutimin e stafit për pozicionin e punës Ekspert/e për menaxhimin e projektit Digital Innovation Unit (DIU) me përbërjen si më poshtë:

- Znj. Fatbardha Gjaci Kryetar (me të drejtë vote)
- Znj. Eriola Kocileri Anëtar (me të drejtë vote)
- Z. Aldo Hoxha Anëtar (me të drejtë vote)

7. Grupi i punës do të asistohet nga Znj. Silvia Tosku në cilësinë e sekretarit. Sekretari i grupit të punës nuk ka të drejtë vote.

8. Grupi i punës të zhvillojë procesin e vlerësimit dhe të hartojë raportin e vlerësimit duke i propozuar titullarit kandidatin e përzgjedhur brenda 7 ditëve kalendarike. Grupi i punës të kryejë hartimin e kontratës së punës.

9. Për përzgjedhjen e fituesit grupi i punës duhet të mbajë në konsideratë Termat e Referencës së hartuara nga "Grupi i Punës për hartimin e Termave të Referencës për rekrutimin për pozicionin-"Ekspert/e i/e Menaxhimit të Projektit Digital Innovation Unit (DIU)".

10. Dokumentacioni shoqërues së bashku me një kopje të proces-verbalit pas miratimit nga ana e Titullarit, të dorëzohet në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për çështjet e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit.

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri "Grupi i Punës për hartimin e Termave të Referencës për rekrutimin për pozicionin-"Ekspert/e i/e Menaxhimit të Projektit Digital Innovation Unit (DIU)" dhe "Grupi i Punës për rekrutimin e stafit për pozicionin e punës Ekspert/e për menaxhimin të projektit Digital Innovation Unit (DIU)".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Delina Ibrahimaj

